



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 130 Prot.

Tiranë, më datë 25.02.2022

**VENDIM**  
**Nr. 40, datë 25.02.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.02.2022:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike i realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji "Abkons" sh.p.k, në kuadër të projektit “Lot 3\_Projektimi dhe Mbikqyrja për Rikonstruksionin dhe Riparimin/Retrofitin e Objekteve Arsimore ‘Shkolla dhe Konvikti ‘Benardina Qerraxhia’”, Durrës, pjesë e programit EU4Schools, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit, me aplikues “Abkons” sh.p.k. dhe zhvillues “U.N.D.P.”;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike sipas konceptit të miratuar për projektin zhvillimor me objekt “Lot 3\_Projektimi dhe Mbikqyrja për Rikonstruksionin dhe Riparimin/Retrofitin e Objekteve Arsimore “Shkolla dhe Konvikti ‘Benardina Qerraxhia’”, Durrës, pjesë e programit EU4Schools, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

